

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është në një partneritet të ngushtë me projektin e RECONOMY, nëpërmjet të cilit AKPA synon të zhvillojë një sërë iniciativash në përmirësimin e shërbimeve publike të punësimit.

Sa i përket pyetjes Suaj, AKPA, në cilësinë e institucionit zbatues të politikave të punësimit dhe aftësive në Shqipëri, ka rritur fokusin në përmirësimin e kapaciteteve të tregut të punës, veçanërisht në sektorin e Ekonomisë së Gjelbër dhe Qarkulluese. Në këtë kuadër, AKPA nëpërmjet Qendrave të Formimit Profesional Publik ofron Kurse të Formimit Profesional në drejtimet:

- Montimi dhe mirëmbajtja e paneleve diellore
- Montimi i paneleve diellore fotovoltaike
- Sisteme të thata

Gjithashtu, në vijim të agjendës europiane digjitale, AKPA ofron gjithashtu për të gjithë qytetarët kurse të Aftësive Digjitale në dy nivele:

- Nivel fillestar
- Nivel Mesatar.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit mes AKPA-s dhe Save the Children për zbatimin e projektit "Rritja e mundësive të qëndrueshme të jetesës dhe nismave sipërmarrëse", ku një prej aktiviteteteve lidhet me promovimin e koncepteve të ekonomisë së gjelbër dhe forcimin e kapaciteteve të ofruesve të PVT publike me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore, të plota dhe të gjelbra:

- Është kryer një Analizë e Nevojave për Trajnim për mësuesit në aftësi të gjelbra, në bazë të të cilit synohet trajnimi i tyre në ekonominë e Gjelbër.